



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1958/Prot.
2

Tiranë, më 21.01 2015

VENDIM

Nr. 06, datë 21/01/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Nga shqyrtimi i ankesës nr. 1958 Prot., datë 31.12.2014 të Qendrës “Res Publica” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare” kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), konstatohet se Qendra “Res Publica” legjitimohet në depozitim të kësaj ankese në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ankuesi Qendra “Res publica” në cilësinë e kërkuesit ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), kërkesën nr. 277/14 Prot., datë 10.11.2014, vërtetuar kjo me recetën postare nr. RR954420121AA, datë 11.11.2014, me objekt, “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”, nëpërmjet të cilës ka kërkuar të informohet lidhur me, 1) Kopje të kontratave të lidhura për mbledhjen e borxhit midis CEZ Shpërndarja Sh.A dhe kompanive Debt International Advisory; Merrcl Consulting; Constal; Elite Consulting; Albania Telecommunication Union; CE2Services; CE2Debt Management si dhe 2) Pasqyrat financiare të të gjithë pagesave të kryera nga CEZ Shpërndarje kundrejt kompanive të sipërpërmendura, për vitin 2010, 2011, 2012, 2013, të ndara në llojin e debisë që këto kompani kanë mbledhur si p.sh.(familjare, biznese, institucione publike, etj.)

Nga provat e administruara bashkëlidhur ankesës rezulton se, OSHEE ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.12740/1 të datës 25.11.2014 duke u shprehur se kontratat e kërkuara parashikojnë ose janë të shoqëruara me marrëveshje konfidencialiteti për mospërhapjen e të dhënave jo vetëm gjatë kohëzgjatjes së tyre por edhe për një afat të papërcaktuar pas përfundimit të tyre.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka kërkuar nga OSHEE që deri në datë 19.01.2015 të depozitohet parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra “Res Publica”. Nga OSHEE është kthyer përgjigje në rrugë elektronike duke dhënë shpjegime sipas të cilave rezultojnë të njëjta me ato të përgjigjes së kthyer kërkuarit.

Nisur nga konstatimet e mësipërme, rezulton se dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi nuk bën pjesë në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, sipas nenit 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ndërsa, nga ana tjetër OSHEE në përgjigjen e dhënë për refuzim të dokumentacionit, duhet të argumentonte dhe bënte balancën, në referim të parashikimeve ligjore të kufizimeve në dhënien e informacionit sipas, nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit, në të cilin parashikohen edhe rastet përjashtimore për dhënie të tij për interes të rëndësishëm publik.

Lidhur me argumentimin e OSHEE-së se “Kopjet e kontratave për mbledhjen e borxhit të lidhura midis CEZ Shpërndarja sh.a dhe kompanive të larpërmendura” përmbajnë në to ose shoqërohen nga marrëveshje konfidencialiteti për ruajtjen e të dhënave, kjo nënkupton formën e duhur dhe parashikimet ligjore që duhet të përmbajë kontratat në një marrëdhënie kontraktuale dhe nuk mund të përdoret si kusht apo kriter për mos dhënie të informacionit.

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ankuesi “Pasqyra financiare të të gjitha pagesave të kryera nga CEZ Shpërndarje kundrejt kompanive të sipërpërmendura... të ndara në llojin e debisë që këto kompani kanë mbledhur si p.sh.(familjare, biznese, institucione publike, etj.)” dhe të refuzuar nga OSHEE, dhënia e dokumentacionit nuk sjell shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale por detyrim të zbatimit të ligjit për drejtën e informimit për dhënie të dokumentacionit të kërkuar për këto kategori.

Në përputhje me përkufizimin e parashikuar në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, “të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt...” çka evidenton dukshëm se dokumentacioni rezervohet në dhënien e tij vetëm nëse ai përmban të dhëna personale dhe përhapja e tyre çënon privatësinë.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, rezulton se nuk ka bërë një interpretim të saktë ligjor për të provuar mbi refuzimin e dhënies së informacionit.

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka parashikuar se, refuzimi i dhënies së informacionit konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18 të tij dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.”.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1958 Prot., datë 31.12.2014 të Qendrës “Res Publica”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar ankuesit brenda datës 02.01.2015.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 21.01.2015.

Besnik DERVISHI

